



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	16.02.2026	26.02.2026	2026/0097

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.02.2026, OE **“FORTESA SH.P.K.”- Prizren**, ka parashtruar ankesë me nr: **2026/0097**, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Projekte infrastrukturore te Zhupes dhe Podgurit. Asfaltimi i rruges Skorrobisht-Kopanavode. projekt trevjeqar”** me nr. të prokurimit: **"622-25-8498-5-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **1,838,000.00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Autoriteti Kontraktues KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, me rastin e nxjerrjes së vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit në fjalë me arsyetim të pajustificueshëm për anulim gjersa komisioni vlerësues na kishte rekomanduar me dhënie të kontratës, ka vepruar në shkelje të rënda të Ligjit të Prokurimit Publik 04/L-042 të konsoliduar, të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik dhe rregullave tjera të prokurimit, duke shkelur në mënyrë thelbësore dispozitat si në vijim:

? Neni 62 par.1.1. (Përfundimi i aktivitetit të prokurimit) i LPP-së të Konsoliduar

Nr. 02/L-042 lidhur me nenin 43.5 pika i) të RRPP

? Neni 40.3 i RRPP-së

? Neni 10 dhe 11 i LPP-së

? Nenit 1 par 2 (Qëllimi) i LPP-së lidhur me parimet bazike nga neni 4.3 i RRPP-së

? Neni 4, neni 6, neni 7, neni 8 dhe neni 48 i Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Njëkohësisht AK me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka bërë shkelje edhe të Nenit 108/A të LPP-së.

Historia procedurale e çështjes së aktivitetit në fjalë

1. Me datën 17 Shtator 2025, AK - “KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT” përmes platformës publike e-prokurimi ka shpallur iniciimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Projekte infrastrukturore të Zhupës dhe Podgurit. Asfaltimi i rrugës Skorrobisht-Kopanavodë, projekt trevjeqar” me nr. prokurimi: 622-25-8498-5-1-1.

2. Kompania jonë, pra Operatori Ekonomik FORTESA SH.P.K. ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit në grup me OE Famis CO - HC SH.A.; Benita Company; ASFALT GROUP SH.P.K.; ZLine Company SH.P.K. duke dorëzuar dosjen e tenderit brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe duke i plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Në këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar dy (2) oferta, të cilat janë:

Nr.	Operatori Ekonomik	Çmimi (me TVSH)
1	Grup i Operatorëve Ekonomik FORTESA SH.P.K.; Famis CO - HC SH.A.; Benita Company; ASFALT GROUP SH.P.K.; ZLine Company SH.P.K.	1,836,717.25 €
2	EUROFAMIS SH.A.	2,169,683.88 €

3. AK me datë 12.01.2026 përmes sistemit kërkon dokumentet e përshtatshmërisë për ofertën tonë dhe në të njëjtën ditë ne i ngarkojmë në sistem dokumentet e kërkuara.

4. Autoriteti Kontraktues me datën 29.01.2026 ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, tek i cili vendim AK anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin: Komisioni vlerësues, pas pranimit të rekomandimit nga KRPP, ndërpreu procesin e vlerësimit dhe rekomandon anulimin e procedurës, sipas nenit 43.5 shkronja (i) të rregullores me nr. 001/2022 verzioni i konsoliduar.

5. Menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare dhe kemi analizuar dokumentet në këtë procedurë.

Pas analizimit të këtyre dokumenteve mund të thuhet se gjatë procedurës formale të

vlerësimit të tenderëve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi, nxjerrjes së vendimeve kontradiktore, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e procesit të vlerësimit.

Në vazhdim do të ofrojmë një deklaratë të qartë, të detajuar dhe të faktuar me argumente të bazuara dhe mbështetshme për secilën nga pretendimet ankimore që do t'i parashtrojmë në këtë “Ankesë” kundrejt vendimit të AK sipas të cilave mund të vëreni shumë lehtë se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-në duke mos i përfillur kërkesat që vet i ka parashtruar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me kriteret e përzgjedhjes dhe kriterit të dhënies së kontratës duke shkelur parimet bazike dhe parimet e vlerësimit të prokurimit.

Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

Pretendimet për shkelje procedurale/materiale gjatë veprimeve dhe aktvendimit të AK-së për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim

Nga ana e Sektorit të Prokurimit të Autoritetit Kontraktues, me vendimin e datës 04.02.2026, është refuzuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga ana jonë, duke u mbështetur në një arsyetim të përgjithshëm, formal dhe të paargumentuar, pa u shoqëruar me fakte konkrete, prova materiale apo analizë juridike të pretendimeve të ngritura.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e Autoritetit Kontraktues, janë konstatuar një sërë shkeljesh procedurale dhe materiale, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në ligjshmërinë dhe rregullsinë e vendimmarrjes dhe të cilat do të elaborohen në vijim.

Konstatimet e paraqitura në të gjitha pikat e vendimit të AK-së janë të mangëta dhe si të tilla nuk janë të bazuara dhe argumentuara me faktet vendimtare në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara nga ne, kërkesave të dosjes së tenderit dhe dispozitave ligjore të LPP-së. Nga ky vendim shihet qartë se AK i ka trajtuar shkarazi dhe në mënyrë selektive pretendimet dhe argumentet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, ashtu që duke u shmangur detyrimeve ligjore dhe duke i anashkaluar faktet vendimtare dhe rrethanave të rastit konkret ka paraqitur pasqyrim të gabuar të gjendjes faktike që nuk përkon me realitetin, rrjedhimisht që e ngatërron gjendjen e saktë faktike dhe përshkrimit ligjor në mënyrë që të na mohoj të drejtën në rivlerësim të drejtë të procesit, me qëllim që të ipet përshtypja se asgjë e paligjshme nuk ka ndodhur. Prandaj, ky arsyetim i vendimit të atakuar nuk e ka vërtetuar saktë dhe drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta e dispozitave materiale të LPP-së (Neni 108/A) përfshirë edhe keqinterpretimi i tyre dhe kërkesave të dosjes së tenderit. Sepse arsyet e dhëna në vendimin e AK-së nuk janë të bazuar në baza ligjore sipas dispozitave të LPP-së dhe pjesës përbërëse të legjislacionit dytësor RRPP Nr.002/2024. Për më tepër arsyetimi i vendimit të AK-së është në kundërshtim edhe me përcaktimet e nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Pretendimet ankimore mbi Vendimin e AK-së për anulim i datës 29.01.2026

Pretendimi i parë (I)

Me datën 29.01.2026, AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, ka nxjerrë Vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit, me arsyetimin se:

Komisioni vlerësues, pas pranimit të rekomandimit nga KRPP, ndërpreu procesin e vlerësimit dhe rekomandon anulimin e procedurës, sipas nenit 43.5 shkronja (i) të rregullores me nr. 001/2022 verzioni i konsoliduar. Në pikpamje faktike dhe ligjore arsyetimi për anulim nuk qëndron. Sipas dokumenteve të siguruara përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare, rezulton se KRPP me datë 20.01.2026 nuk ka dhënë rekomandim për anulim të aktivitetit të prokurimit, por vetëm vërejtje drejtuar Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit (ZPP), lidhur me disa kritere që nuk ishin ndryshuar në FTD, pavarësisht kërkesës paraprake të KRPP-së.

Pra, dokumenti i KRPP-së përbën vërejtje administrative dhe jo rekomandim për anulim të procedurës. Kjo vërtetohet qartë edhe nga përmbajtja e dokumentit, ku theksohet shprehimisht: “KRPP - kërkon nga Autoriteti Kontraktues përkatësisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të ndërmarrin masa që mos të përsëriten lëshimet siç është rasti konkret sepse në rast të përsëritjes së lëshimeve jemi të detyruar të ndërmarrim masa pa paralajmërim në pajtim me nenin 25 LPP-së dhe nenin 96 dhe 97 të Rregullores për Prokurim Publik”

Nga ajo më sipër, është e qartë se KRPP në asnjë mënyrë nuk ka kërkuar anulimin e aktivitetit të prokurimit, por vetëm ka paralajmëruar masa eventuale në rast të përsëritjes së shkeljeve në të ardhmen.

Në këtë kontekst, shtrohet pyetja legjitime: si mundet Autoriteti Kontraktues të anulojë një aktivitet të prokurimit, për të cilin operatori ekonomik ishte rekomanduar për shpërblim me kontratë nga Komisioni Vlerësues me datë 12.01.2026, vetëm mbi bazën e një vërejtjeje të KRPP-së, dhe jo një rekomandimi për anulim?

Dëshmi 1: Aneksi 1 (Dëshmi nga sistemi i e-prokurimit në lidhje me kërkesën e AK-së për dokumentet e përshtatshmërisë)

Kjo bëhet edhe më e pakuptimtë duke pasur parasysh faktin se për të njëjtin aktivitet të prokurimit ekziston Vendimi i OSHP-së nr. 1083/2025, me të cilin Paneli Shqyrtues i ka lejuar Autoritetit Kontraktues që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit.

Nga të gjitha këto prova relevante të bazuara në gjendjen faktike dhe kërkesat ligjore të legjislacionit të zbatueshëm të prokurimit vihet në përfundim se Vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit ka qenë në tërësi i paligjshëm. E aq më tepër, justifikimet në të cilat është thirrur AK si pretekst për anulim arbitrar të aktivitetit me qëllim që të na pamundësohet realizimi i kontratës të fituar më parë nga një proces i rregullt ligjor nga vet AK-ja.

Andaj në rastin konkret në pikpamje faktike dhe ligjore nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet e nenit 62 të LPP-së dhe nenit 43.5 pika i) të RRPP-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Dispozita ligjore në të cilën është thirrur AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit, nuk qëndron për faktin se kjo dispozitë është keqinterpretuar apo zbatuar në mënyrë të

gabueshme.

Ndërsa baza e arsytimit nuk qëndron, sepse mënyra e paraqitur paraqet supozime dhe imagjinim të situatave joreale dhe jo gjendjen e saktë faktike. Dhe për më tepër nuk ka asnjë ngjarje objektive që është jashtë kontrollit të AK dhe që nuk ka mundur të parashikohet pasi që aktiviteti ka kaluar në mënyrë të ligjshme në të gjitha stadet e procedurës.

Në këtë mënyrë, AK ka shkelur dispozitat e ligjit material nga neni 62 i LPP-së lidhur me dispozitat e legjislacionit sekonadar nga neni 43.5 pika i) të RRPP-së.

Pretendimi i dytë (II)

Komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.1 të LPP-së dhe nenin 40.1 të RrPP-së, pasi është i obliguar që të vlerësojë dhe krahasojë vetëm tenderët e përgjegjshëm, duke u mbështetur në kriteret për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Gjithashtu, sipas nenit 40.13 të RrPP-së, procesi i vlerësimit duhet të kryhet në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara paraprakisht dhe pa devijime nga kërkesat ligjore dhe dokumentacioni i tenderit. Në këtë rast, komisioni nuk ka respektuar këtë obligim, pasi pas rekomandimit tonë për shpërblim me kontratë me datë 12.01.2026, pastaj përmes procesverbalit të datës 26.01.2026 rekomandon anulimin e aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me detyrat e tyre të cilat i përcakton ligji.

Kjo mënyrë veprimi ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin përfundimtar të aktivitetit të prokurimit dhe përbën shkelje të parimeve të ligjshmërisë, barazisë dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë, të garantuara nga LPP.

Pretendimi i tretë (III)

AK ka bërë Shkelje të rëndë (Neni 97.1 pika k) të RRPP-së) pasi me provat e mësipërme dëshmohet se kemi të bëjmë me: Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Pretendimi i katërt (IV)

AK ka bërë Shkelje të rëndë (Neni 97.1.o të RRPP-së) pasi me provat e mësipërme dëshmohet se kemi të bëjmë me sjellje të gabuar dhe jo profesionale të zyrtarit përgjegjës të prokurimit ndaj kompanisë sonë. Kjo pasi i njëjti është i obliguar sipas Nenit 39.4 të RrPP-së të organizoj punën e komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP.

Në këtë rast, edhe zyrtari përgjegjës ka dështuar të përmbushë këtë obligim ligjor, duke lejuar veprime dhe vendime që kanë cenuar parimin e ligjshmërisë, barazisë dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së, ndonëse kompania jonë ka përmbushur të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, por megjithatë është bërë anulimi i aktivitetit të prokurimit.

Prandaj, faktet dhe rrethanat e lartcekura vërtetojnë se vendimi i AK-së është i kundërligjshëm, pasi gjatë procedurës së vlerësimit është vendosur në dëm të tenderit/ofertës së OE ankues, duke na mohuar të drejtën e ligjshme për shpërblim me kontratë, pavarësisht faktit se kemi paraqitur ofertë të përgjegjshme dhe me çmimin më të ulët. Duke marrë

parasysh se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e sipërpërmendura të LPP-së dhe akteve nënligjore, dhe se si pasojë e këtyre shkeljeve jemi dëmtuar drejtpërdrejt, pasi kemi paraqitur ofertë të përgjegjshme dhe kemi plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit, kërkojmë nga OSHP që të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë të gjitha faktet e paraqitura në këtë ankesë.

Duke u udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, barazisë, mosdiskriminimit, pavarësisë dhe paanësisë në vendimarrje, i propozojmë OSHP-së që të marrë këtë:

VENDIM

? APROVOHET SI E BAZUAR ankesa nga OE “**FORTESA SH.P.K.**”

? ANULOHET Njoftimi mbi Vendimin e AK-së për anulim i publikuar me dt. 29.01.2026 në ueb faqe të KRPP-së, dhe lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM**.

Nëse faktet dhe argumentet e paraqitura në këtë ankesë nuk merren parasysh dhe nuk shqyrtohen në mënyrë të drejtë dhe objektive, do të ndjehemi të detyruar të vazhdojmë procedurat ligjore në institucionet tjera kompetente, për të mbrojtur të drejtat tona ligjore dhe ekonomike. Në këtë kuadër, do të kërkojmë përgjegjësi përmes rrugëve të parashikuara me ligj ndaj të gjitha palëve të përfshira në këtë aktivitet të prokurimit, të cilat përmes veprimeve apo mosveprimeve të tyre kanë ndikuar në cenimin e interesit tonë të ligjshëm.

KRITERET PËR VLERËSIM

--

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES –B 58

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: **Projekte Infrastrukturore të Zhupës dhe Podgurit, Asfaltimi i rrugës Skorrobisht Koponavodë, projekt 3 vjeçar.**

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	622-25-8498-5-1-1
Numri i brendshëm Internal No Interni broj	

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës së çmimit të peshuar
1.	EuroFamis SH.A	2169683.88
2.	GOE:Fortesa Sh.P.K, Famis CO-HC Sh.P.K, Benita Company, Asfalt Group Sh.P.K, Zline Company Sh.P.K	1836717.25

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna Prizrenit e shpërblen me :

Ose

[shëno emrin e Autoritetit Kontraktues] anulon¹ aktivitetin e prokurimit [Ne rast të anulimit të aktivitetit të prokurimit shëno arsyetimin për anulim]:

Komisioni vlerësues, pas pranimit të rekomandimit nga KRPP, ndërpreu procesin e vlerësimit dhe rekomandon anulimin e procedurës, sipas nenit 43.5 shkronja (i) të rregullores me nr.001/2022 vlerzoni i konsoliduar.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

///

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **FORTESA SH.P.K.**

Aktivitetin i prokurimit me titull: **“Projekte infrastrukturore te Zhupes dhe Podgurit. Asfaltimi i rruges Skorrobisht- Kopanavode. projekt trevjeqar”** me nr. të prokurimit: **“622-25-8498-5-1-1”**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, ku Autoriteti Kontraktues (AK) anulon aktivitetin me arsyetimin:

“Komisioni vlerësues, pas pranimit të rekomandimit nga KRPP, ndërpreu procesin e vlerësimit dhe rekomandon anulimin e procedurës, sipas nenit 43.5 shkronja (i) i rregullores me nr.001/2022 verzioni i konsoliduar”

OE ankues pretendon se AK pas hapjes së ofertave nuk mund të arsyetohet me anulim, për arsye se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) nuk ka urdheruar që të anulohet aktiviteti, dhe ky anulim është në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

(Shënim: Të gjitha pretendimet ankimore të ankesës janë të përshkruara lartë në raportë, më saktësisht të Dispozitat e shkelura dhe Pretendimet Ankimore.)

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron kronologjinë si mëposhtë:

Data e njoftimit për kontratë është 16/09/2026;

Korrigjimi i parë është bërë me datë 23/10/2025;

Korrigjimi i dytë është me datë 03/11/2025 dhe

Korrigjimi i tretë është me datë 11/12/2025;

Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik me datë 26/09/2025 ka dërguar rekomandim për rishikim të kërkesave të vendosura në dosje të tenderit.

Me datë 21/10/2025 në E-Prokurim gjenden kërkesat për rishqyrtim në fazë të kriterëve, ku AK ka aprovuar pjesërisht kërkesën duke ndryshuar disa nga kërkesat e dosje së tenderit, mirëpo i njëjti parashtron ankesë edhe në OSHP me nr: 1083/2025, mirpo para se të publikohet raporti i ekspertit tërhiqet nga ankesa dhe si e tillë publikohet Vendimi i PSH- tërheqje 27/11/2025, dhe rrjedhimisht AK vazhdon me hapje të ofertave me datë 16/12/2025.

Vlenë të theksohet se në AK me datë 29/10/2025 parashtron kërkesë për rishqyrtim edhe një operator tjetër ekonomik, të cilën AK ia refuzon si të pa bazuar, por i njëjti pastaj nuk ka atakuar vendimi i AK-së në OSHP.

Tutje, pas hapjes së ofertave me datë 16/12/2025, komisioni i vlerësimit me datë 13/01/2026 ngarkon raportin mbi vlerësimin e ofertave, duke rekomanduar për kontratë OE ankuesin.

Mirëpo me datë 20/01/2026 KRPP dërgon prap shkresë përmes E-Prokurimit, të cilët e paralajmërojnë se do të ndërmarin masa herave të tjera për mos zbatim të rekomandimit dhe mos kthim të përgjigjes në E-Prokurim.

Dhe si e tillë, me datë 23.01.2026 Zyra e Prokurimit njofton Komisionin e Vlerësimit për shkresën e KRPP-së, andaj të njëjtit rekomandojnë anulim të aktivitetit sipas rekomandimit të KRPP-së.

Rrjedhimisht me datë 29/01/2026 Autoriteti Kontraktues publikon Vendimin mbi anulimin e Aktivitetit të Prokurimit me arsyetimin: sipas rekomandimit të KRPP-së, një shkelje e ligjit ka ndodhur dhe nuk mund të rregullohet.

Pra, sipas analizmit të shkresave të lëndës, AK nuk ka përfillë rekomandimet e KRPP-së, duke mos kthyer as përgjigje sa i përket monitorimit të aktivitetit të prokurimit.

AK ka vazhduar me hapje të ofertave, ka pranuar raportin e komisionit për rekomandim të OE ankues, dhe pastaj pas reagimit të dytë të KRPP-së, AK mundohet që të bëjë përmirësimet me anulim të Aktivitetit të Prokurimit.

Sipas ligjit të Prokurimit Publik neni 62 dhe bazuar edhe në nenin 43.5 të Rregullores për Prokurim publik, ky arsyetim i Ak-së pas hapjes së ofertave nuk përkon me pikat si arsye të anulimit.

Komisioni i vlerësimit posedon mandatin për vlerësim të ofertave sipas kriterëve dhe kërkesave të dosjes së tenderit, siç ka vepruar me datë 13/01/2026.

Sipas përmbajtjes së rekomandimit që KRPP ka dërguar, **nuk thuhet shprehimisht që aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet pas hapjes së ofertave.** KRPP thekson se AK dhe zyrtari përgjegjës duhet të kenë më shumë kujdes në hartimin e dosjes së tenderit dhe vendosjen e kriterëve, në përputhje me legjislacionin. Kërkohet që të ndërmerren masa të brendshme për të mos përsëritur lëshime si në rastin konkret. Paralajmërohet se në rast përsëritjeje, KRPP do të ndërmarrë masa pa paralajmërim, në bazë të nenit 25 të LPP-së dhe neneve 96–97 të Rregullores.

Si përfundim, bazuar në shkresat e lëndës në E-Prokurim, KRPP ka paralajmëruar për masa ndëshkimore nëse AK vazhdon ose përsëritë veprime si në rastin konkret, andaj edhe ky anulim nuk përkon me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43.5 të RrPP-së, ankesa e OE ankues gjendet e bazuar, dhe aktiviteti të ktheht në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**FORTESA SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Projekte infrastrukturore të Zhupës dhe Podgurit. Asfaltimi i rrugës Skorrobisht- Kopanavodë, projekt trevjeqar**” me numër të prokurimit: “**622-25-8498-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**FORTESA SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Projekte infrastrukturore të Zhupës dhe Podgurit. Asfaltimi i rrugës Skorrobisht- Kopanavodë, projekt trevjeqar**” me numër të prokurimit: “**622-25-8498-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **FORTESA SH.P.K.**

Blerina Huruglica

